



In medias res

## PLANIFIKIMI PROCES IMEDIAT I NDRYSHMIT

*“Të dështosh në planifikim do të thotë të planifikosh dështimin”*

Ad-hokkratia gjithnjë ka qenë dhe do të jete shkaktare e ngecjeve, degradimeve, krizave dhe pengesë e ndryshimeve pozitive në shoqëri në përgjithësi dhe, në arsim në veçanti. Ad-hokkraci do të thotë që punët të ecin sipas spontanitetit, inercionit. Kjo qasje, quhet ndryshe qasje reaktive, ecje pas ngjarjeve që dikush i imponon. Në vend të kësaj qasjeje duhet vendosur qasjen proaktive, qasjen e krijimi të ngjarjeve të reja të cilat prodhojnë ndryshime pozitive të dëshiruara dhe të dobishme për qytetarët në përgjithësi dhe, për fëmijët dhe nxënësit në veçanti. Vendet e zhvilluara planifikojnë për tri gjenerata.

Kjo praktikë e planifikimit afatgjatë nuk ka qenë traditë dhe praktikë e përhershme në shoqërinë kosovare, në përgjithësi dhe në fushën e arsimit në veçanti. Mungesa e një procesit të planifikimi si një qasje proaktive ndaj realiteti ka bërë që shoqëria kosovare të mos ketë vizione, synime, qëllime dhe objektiva të qarta drejt të cilave do të duhej të orientonte energjinë, mundin dhe angazhimin e vetë.

Çështja e parë të cilën duhet ndryshojmë të punojmë në ndryshimin e vetëdijes të fëmijët, nxënësit, studentët qytetarët është rritja e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë që ka planifikimi për artikulimin e një të ardhme e cila do të plotësojë maksimalisht nevojat e qytetarëve dhe në të cilin qytetarët do të kenë mundësi të plota për vetë-realizimin, për mirëqenie, arsimim gjatë gjithë jetës, për ndërveprim human ndërmjet njerëzve të ndryshëm duke pranuar nga të tjerët dhe duke u dhënë më të mirën nga vetja e vetë. Në këtë mënyrë planifikimi bëhet mjet global për ruajtjen e paqes në botë.

PO si të ngrihet vetëdija për rolin dhe rëndësinë e planifikimit?. Janë tre faktorë crucial që mund të ndikojnë në rritjen e vetëdijes për rolin dhe rëndësinë e planifikimit:

**Faktori i parë** i ndërgjegjësimit është arsimi. Kjo do të thotë se përmbajtjet që lidhen me planifikimin duhet të jenë pjesë integrale kurrikulare në të gjitha fushat disiplinare duke filluar nga edukimi parashkollor deri te ai pasuniversitar, natyrisht duke respektuar moshën dhe aftësitë e nxënësve. Që nga kjo moshë duhet të zhvillohen dijet dhe kompetencat/ aftësitë, shkathtësitë dhe shprehjet, qëndrimet dhe vlerat që lidhen me procesin e planifikimit. Procesi i planifikimi duhet të ushtrohet dhe të zbatohet, në mënyrë që kë të jetë një shprehje e sjelljes veprimit të secilit qytetarë. Në secilën lëndë në secilën klasë nxënësit jo vetëm që duhet të mësojnë për planifikimin, por ata duhet edhe ta zbatojnë sepse në këtë mënyrë ata e kuptojnë se e ardhmja e tyre në masën më të madhe është proces i planifikimit.

**Faktori i dytë** ka të bëjë me infrastrukturën ligjore. Përgjegjësia për planifikim afatgjatë, afat-shkurt dhe afatmesëm duhet përcaktohet me ligj në mënyrë që planifikimi të jetë pjesë e kulturës dhe performancës institucionale ashtu edhe të performancës individuale. Nuk mund mendohet më zhvillimi dinamik i shkollave nëse shkollat nuk hartojnë Planet zhvillimore – strategjike.

**Faktori i tretë** janë mediet, të cilat planifikimin duhet ta trajtojnë si mjet të qeverisje dhe të udhëheqjes së suksesshme.

Planifikimi i ndryshimeve është *conditio sine qua non* për ndryshime dhe për nismat reformuese në arsim. Në ndryshimet reformuese në Kosovë kjo ka qenë Thembër e Akilit.

*Shkroi: Halim Hyseni*

## **Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH**

■ Më 5 dhjetor 2009 është mbajtur takimi gjysmë ditor me 38 mësime të cilët që janë duke u trajnuar në kuadër të programit të MKLSH-së. Në këtë takim trajnerët analizuan orët e monitoruara dhe dhanë instruksione për zbatimin me sukses të teknikave dhe strategjive të caktuara në lëndët e ndryshme. Nga fletët e monitorimit kuptohet se këtë herë monitorimin ishte më i suksesshëm falë përkushtimit më të madh të mësimeve që ndikoi dhe në performacën e tyre. Pas takimit gjysmë ditor, pra në pasditen e 5 dhjetorit dhe më 6 dhjetor është mbajtur seminari i shtatë dhe i fundit për këta mësime. Në fund 38 pjesëmarrësve të rregullt iu shpërndanë certifikatat.

■ Më 5-6 dhjetor si dhe 16-17 janar 2010 është mbajtur seminari i dytë dhe i tretë për 120 mësime të cilët që janë duke vijuar programin e MKLSH. Trajnimi i këtyre mësimeve është organizuar në 4 grupe: në Prishtinë, Ferizaj, Gjilan dhe Pejë. Gjatë muajit janar ka filluar dhe monitorimi i këtyre mësimeve në klasa. Orët e monitoruara do të diskutohen më 20 shkurt 2010.

■ Më 6-8 janar 2010 është mbajtur seminari i tretë për 25 drejtorë të shkollave të komunës së Prishtinës dhe Obiliqit. Gjatë këtyre 3 ditëve trajnerët kanë paraqitur para drejtorëve përmbajtjet e udhëzuesve 5 dhe 7 të programit të MKLSH-së. Trajnimi i drejtorëve ka për qëllim aftësimin e drejtorëve për të realizuar me sukses monitorimin e mësimeve të tyre në klasa.

## **Monitorimi i menaxhimit të financave komunale të arsimit në 5 komuna të Kosovës**

■ Gjatë muajit dhjetor dhe janar KEC ka vazhduar zbatimin e projektit "Monitorimi i menaxhimit të financave komunale të arsimit në 5 komuna të Kosovës". Gjatë muajit dhjetor është bërë analiza e pyetësorëve dhe raportimi i rezultateve. Gjatë muajit janar janë realizuar disa intervista me përfaqësues të DKA në Gjakovë, Prishtinë, Vushtrri, Istog dhe Gjilan për të shqyrtuar më hollësisht disa aspekte të menaxhimit të financave komunale të arsimit në këto komuna.

## **Krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla**

■ Faza PILOT e këtij projekti ka përfunduar me 31 dhjetor 2009. Gjatë muajit janar është përgatitur Raporti FINAL për ndryshimet prodhuara nga zbatimi i Projektit. Në ndërkohë është përgatitur foto-dokumentacioni i ndryshimeve dhe i gjendjes në 168 shkolla pilot. Janë mbi 3,600 fotografi.

■ Në ndërkohë është përgatitur edhe Projekti IDEOR për finalizimin e formimit të Rrjetit MBROJTËS TË MJEDISEVE TË SIGURTA DHE PËR PARANDALIMIN E DHUNËS.

Po ashtu, është përgatitur edhe DRAFT-PROTOKOLI I VEÇANTË PËR PARANDALIM DHE REAGIM NDAJ DHUNËS

Në komunën PILOT në GJILAN të gjitha shkollat e kësaj komune i kanë hartuar Planet Zhvillimore për periudhën 2009 - 2010

## **Ngritja e cilësisë në edukimin e fëmijërisë së hershme**

■ Në kuadër të këtij projekti u zhvilluan një varg trajnimesh që kishin për qëllim aftësimin e drejtorëve të shkollave fillore dhe institucioneve parashkollore për vlerësimin e mësimdhënësve me anë të instrumentit të unifikuar për zhvillimin e EFH. Ky instrument i vlerësimit, drejtorëve u ndihmon të jenë sa më objektiv dhe argumentues gjatë monitorimit.

Në këto trajnime 3 ditore u përfshinë më se 300 pjesëmarrës nga këto komuna: Prishtinë, Ferizaj, Prizren, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, dhe Skenderaj. Në Pejë me kërkesën e Drejtorisë Komunale të Arsimit u realizua edhe trajnimi i dytë, në këtë grup kishte edhe drejtor shkollash nga Istogu e Klina. Zyrtarët dhe inspektorët e arsimit nga këto komuna shprehën dëshirë të jenë pjesë e këtyre trajnimeve, kështu që, u organizua një trajnim i veçantë. Po ashtu një grup i veçantë u organizua për drejtorët e Institucioneve Parashkollore.

Të gjithë pjesëmarrësit 2-3 javë pas trajnimit kanë marrë pjesë edhe në monitorim në praktikë, që ishte edhe kusht për certifikim.

Çdo grup përcaktonte shkollën dhe së bashku realizohej monitorimi i parë në çifte në një klasë dhe pas 2-3 jave, organizohet monitorimi i dytë me nga 6 veta. Çdo grup në fund të ditës së dytë të monitorimit kishte një punëtor me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe ideve që dolën si rezultat i kësaj praktike.

Pas trajnimeve, monitorimit në praktikë si dhe gjatë takimeve të ndryshme të organizuara me pjesëmarrësit janë marr informata dhe ide për praktikën e shfrytëzimit të instrumentit për monitorim.

Këto janë idetë për ndryshim të instrumentit të monitorimit dhe të përdorimit të tij:

- Mundësia që të mos vlerësohen të gjitha standardet përnjëherë do të lehtësonte monitorimin
- Notat e vlerësimit (1-4) të ndryshohet ashtu që të shtohet edhe një note vlerësuese 1-5
- Ky ndryshim do të mundësonte ndryshimin e vlerësimit në përqindje
- Ndryshime në përmbajtja e disa fjalive (p.sh. largimi i rrethanorit – çdo ditë)
- Terminologjia në instrumentin të përshtatet edhe për parashkollorët (mësimdhënës/edukator, klasë/dhomë,...)
- Të organizohen trajnime edhe për personat që monitorohen
- Të hartohet instrumenti dhe të organizohen trajnime për monitorimin e mësimdhënësve lëndorë.

Rezultatet e trajnimeve, instrumenti i vlerësimit të monitorimit dhe këto ndryshime u paraqitën në tryezën e rrumbullakët të organizuar me datën 13 dhjetor, si aktivitet përmbyllës i projektit, ku morën pjesë pjesëtarë nga MASHT, zyrtar dhe inspektor të arsimit, drejtor të shkollave fillore dhe të Institucioneve Parashkollore si dhe mësimdhënës dhe edukatorë. Në këtë tryezë përvojat e monitorimit të performancës së mësimdhënësve në Slloveni i prezantoi Tatjana Vonta, udhëheqëse e Institutit Pedagogjik, si the Aija Tuna foli në emër të Asociacionit Ndërkombëtar të Hap pas Hapit-ISSA.

## **Aftësimi i edukatorëve të Institucioneve parashkollore për dramatizim**

■ Gjatë muajit janar, me datat 23, 24, 30 31 u organizua trajnimi i tretë për edukatorët e Institucioneve Parashkollore të Komunës së Prishtinës, rreth skenarit, dramatizimit, kostumeve dhe kukullave,

financuar nga Drejtoria Komunale Arsimore e Prishtinës. Morën pjesë 48 edukatore të cilat punojnë me grup moshat 3-6, nga këto I.P: Dielli, Lulevera, Sos Kinderdorf dhe Yllkat.

Pjesa praktike që do të zgjatë dy ditë për secilin I.P. do të kryhet me organizimin e shfaqjeve të cilat do të realizohen me rastin e 17 shkurtit- Ditës së Pavarësisë së Kosovës dhe 7 marsit-Ditës së Mësuesit. Realizimi i këtyre shfaqjeve është kusht për certifikim të pjesëmarrësve.

Dy grupet e para të përfshira në trajnim ku morën pjesë edukatorët e 6 I.P të Prishtinës realizuan shfaqjet me rastin e festës së Vitit të Ri, si pjesë përmbyllëse të trajnimit

## KOSOVISION Contest

■ Projekti KOSOVISION CONTEST mbajti ceremoninë e shpërblimeve më 5 dhjetor të vitit 2009. Në këtë ceremoni ishin të ftuar rreth 600 mysafirë duke filluar nga nxënës, drejtorë shkollash dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme. Kjo ceremoni u mbajt me rastin e përfundimit të fazës së parë të projektit KOSOVISION CONTEST 2. Gjatë ceremonisë u shpallën fituesit e këtij viti. Fitues për realizimin e projekteve sipas këtij projekti ishin 85 klasa të pesta nga e gjithë Kosova.



Përveç ndarjes së çmimeve në nivel të shkollave është bërë edhe ndarja e tri çmimeve me short dhe këto klasa kanë

fatim që gjatë muajit shkurt të kalojnë dy ditë në Brezovicë. Klasat fituese në këtë short janë:

1. "Naim Frashëri" me mësuesen Remzije Baraku;
- 2." Ruzhdi Xhyliqi" me mësues Skënder Paqarizi dhe
3. "Trepca" me mësuese Mehrije Buleshkaj-Haxhijaj.



■ Po ashtu që nga data 5 dhjetor e deri më 10 dhjetor është organizuar edhe ekspozita e nxënësve me rreth 1300 punime të ndryshme. Kjo ekspozitë ka pasur vizitorë të shumtë gjë që ka bërë që vet fëmijët të ndahen shumë të kënaqur me punën e tyre.

■ Gjatë muajit janar të vitit 2010 në kuadër të këtij projekti kanë filluar edhe përgatitjet për trajnimin e mësimeve të klasave fituese. Trajnimet kanë filluar të mbahen që nga 25 janari duke filluar me mësime të Rajonit të Prishtinës dhe kanë zgjatur gjatë tërë javës duke përfunduar në Gjakovë me mësime të këtij rajoni.



Në këto trajnime mësimdhënësit janë mësuar për punën të cilën duhet kryer së bashku me nxënësit e po ashtu edhe janë pajisur me materialet të cilat iu duhen për të filluar dhe dokumentuar punën e tyre me nxënës. Foto nga trajnimi.

## Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të këtij projekti "Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e edukimit", financuar nga Komisioni Evropian, janë organizuar aktivitetet sipas projektit. Futja e të dhënave nga pyetësorët e zhvilluar gjatë monitorimit të parë ka përfunduar dhe tani jemi në fazën kur do të dalim me një raport mbi monitorimin e parë. Doracaku për trajnim është përgatitur dhe pas konsultimeve të bëra me donatorët ai doracak është dorëzuar në shtyp. Në fund të këtij muaji janë bërë edhe përgatitjet për trajnimin e nxënësve dhe besojmë që në muajin shkurt fillojmë edhe me këto trajnime.



■ Këtë muaj është bërë edhe plani i detajuar i aktiviteteve për vitin e dytë të projektit e po ashtu është punuar edhe në raportin vjetor të projektit.

## Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim

■ Në kuadër të komponentës 2 të Projektit "Hulumtimet Kombëtare" gjatë muajit dhjetor dhe janar janë bërë hulumtimet në pesë shtetet pjesëmarrëse në projekt. Hulumtuesit fillimisht kanë shfletuar ligjet, dokumentet dhe politikat që kanë të bëjnë me përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e grupeve pakicë në sistemin shkollor. Më pas kanë vizituar shkollat e përzgjedhura dhe kanë kryer intervista me drejtorët e shkollave, nxënësit nga grupet pakicë dhe prindërit nga grupet pakicë. Pas përfundimit të punës në terren disa nga hulumtuesit kanë arritur t'i përfundojnë raportet.

■ Sa i përket komponentës 3 të projektit "Praktikat më të mira" ekipet kombëtare në shtetet pjesëmarrëse në projekt i kanë shpallur ftesat për aplikim të praktikave më të mira. Gjithashtu është biseduar me palët me interes në shtetet përkatëse për këto praktika, në mënyrë që të ketë distribuim sa më të mirë të informatës.

## Prevention on Peer Violence

■ Këtij projekti po i afrohet fundit. Sipas kontratës projekti përfundon në fund të muajit shkurt. Gjatë muajit dhjetor 2009 dhe janar 2010 kanë vazhduar punëtoritë e nxënësve nëpër klasa. Gjatë vizitës së bërë dhe monitorimit të këtyre punëtorive kemi ardhur në përfundim se të gjitha këto shkolla të cilat kanë qenë përfituese të projektit janë avancuar mjaft dhe kanë bërë ndryshime të mëdha në këtë fushë.



### Stop Bullying

■ Trajnimet apo punëtoritë për dhunën ndaj bashkëmohatarëve janë të domosdoshme në të gjitha shkollat e Kosovës. Ato ndihmojnë në vetëdijen e nxënësve për një miqësi më të madhe ndërmjet tyre.

### Avancimi i komunikimit me prindër në shkollat e Kosovës

■ Gjatë dhjetorit në kuadër të projektit “Avancimi i komunikimit me prindër në shkollat e Kosovës” janë mbajtur intervistat me drejtorët e shkollave pjesëmarrëse në projekt dhe u janë shpërndarë pyetësorët mësimdhënësve. Pas intervistave dhe mbledhjes së pyetësorëve të plotësuar është shkruar edhe raporti. Ky raport do tu prezantohet palëve me interes.

### Access Microscholarship Program

■ Më 21 dhjetor u ndërprejnë orët e Access për shkak të festave të fund vitit dhe pushimit dimëror. Ky pushim zgjati deri më 19 janar kur edhe filluan orët e Access sërish.

■ Edhe gjatë kësaj periudhe përgjegjësit në Ambasadën Amerikane janë munduar ta sigurojnë një profesor të gjuhës angleze

për t'i mbajtur orët e Access me grupin e Prizrenit.

### Edukimi për Drejtësinë Shoqërore

■ Gjatë muajit dhjetor është mbajtur punëtorja 5 ditore. Dy ditët e para të punëtorisë ishin të fokusuar vetëm në punën me trajnerët vendor. Eksperti amerikan Nabil Oudeh, Ekspert për zgjidhjen e padhunshme të konflikteve, u prezantoi trajnerëve shembuj të tërë në këtë problematikë. Gjithashtu, ai e prezantoi edhe librin e tij. Trajnerët pastaj këto njohuri i kryqëzuan me njohuritë nga EDSH, dhe i ofruan një trajnim shumë të pasur me se 35 pjesëmarrësve nga shkollat, OJQ-të, institucionet e ndryshme.



■ Pas suksesin të këtij trajnimi, u organizuar edhe 6 trajnime tjera në tre qendra të Kosovës, në Peje, Gjilan dhe Prizren. Duhet theksuar se ky trajnim u mirëprit shumë nga të gjithë pjesëmarrësit. U kërkua që trajnime të tilla të organizohen sa më shumë.



■ Gjithashtu, si aspekt shumë pozitiv në këtë proces u pa bashkëpunimi shumë i mirë i trajnerëve nga Kosova me ekspertin nga Amerika.

### **Koncepti i qytetarisë të nxënësit e shkollës fillore në Kosovë**

■ Gjatë kësaj periudha janë finalizuar instrumentet e hulumtimit. Në fund të muajit janar, partnerët nga universiteti i Zurichut kanë qenë për vizitë në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe ekipet nga KEC, Fakulteti i Edukimit dhe Universiteti i Zurichut, kanë zhvilluar një hulumtim të shpejt në 4 shkolla të mesme të Prishtinës.

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte testimi i instrumenteve të hartuara.

Vizita e partnerëve zviceranë në Kosovës kishte edhe karakter të shkëmbimit të përvojave.



■ Nga të dhënat që kanë dalë pas këtij hulumtimi është vërejtur se shumica e pyetjeve në këta pyetësor janë shtruar mirë, dhe për nxënësit nuk ka qenë vështirë të kuptohen. Megjithatë, analiza e tyre na ka sjellë edhe disa komente dhe sugjerime edhe nga mësuesit e tyre, me të cilët u zhvillua anketimi.

■ Aktivitetet që do të pasojnë në kuadër të këtij projekti do të jenë,

finalizimi i pyetësorit me komentet dhe sugjerimet, si dhe draftimi i projekt propozimit, për një projekt më gjithëpërfshirës në këtë fushë.

### **Projekti i përbashkët i historisë së Evropës Juglindore (JHP)**

■ Në kuadër të këtij projekti, gjatë këtij muaji kanë vazhduar përgatitjet për mbajtjen e trajnimit për trajnerë. Është duke finalizuar Udhëzuesi që do të përdoret si mjet ndihmës apo udhërrëfyes për përdorimin e Librave të punës (setit prej katër librave që shpërndahet tek mësimdhënësit pas trajnimit). Janë caktuar datat e trajnimit ato do të jenë me 6-7 shkurt.

*Përgatiti: Petrit Tahiri*